NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 23.10.2026

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor me masën "Shkarkim nga detyra" ndaj gjyqtares A.Xh.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor ndaj magjistrates A.Xh, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, bazuar në ankesën e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, lidhur me mosparaqitjen në punë të gjyqtares A.Xh. Gjatë hetimit të rastit, ILD ka identifikuar edhe shkelje të tjera disiplinore, duke e shtuar kështu objektin e hetimit ndaj gjyqtares.

Nga analiza e fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit disiplinor, rezultojnë të provuara ndaj magjistrates A.Xh. shkeljet disiplinore të mëposhtme:

- *Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi*, e verifikuar në dy procedime penale, pavarësisht ekzistencës së lidhjeve të afërta familjare me të pandehurit.
- *Mospërmbushja e pajustifikuar dhe e përsëritur e funksionit gjyqësor*, e evidentuar përmes shtyrjes së seancave pa shkaqe objektive dhe të provuara, përfshirë 38 seanca pa arsye konkrete dhe 29 seanca të shtyra për arsye familjare të paprovuara.
- *Vonesa të përsëritura dhe zvarritje të pajustifikuara të veprimeve dhe akteve procedurale,* të evidentuara nga 341 vendime të mbetura në pritje për arsyetim, prej të cilave 331 jashtë afatit ligjor, si dhe dorëzimi i vetëm 4 vendimeve të arsyetuara gjatë periudhës janar–qershor 2026 dhe ekzistenca e vendimeve të pashpallura për periudha të zgjatura.
- *Mungesa e pajustifikuar në detyrë për më shumë se tri ditë pune në vit*, konkretisht për 23 ditë gjatë muajve shkurt dhe mars 2026, pa dokumentacion justifikues.
- *Shkelja e përsëritur e rregullave të sjelljes në marrëdhëniet institucionale dhe profesionale*, e manifestuar në komunikimin me drejtuesit, administratën gjyqësore dhe personelin mbështetës, përmes sjelljeve dhe shprehjeve të papërshtatshme të provuara gjatë hetimit disiplinor.

Raporti i ILD konkludon se shkeljet e gjyqtares A.Xh. nuk përbëjnë episode të izoluara, por karakterizohen, për një pjesë të tyre, nga përsëritja, vazhdimësia dhe ndikimi në zhvillimin e proceseve gjyqësore, funksionimin e gjykatës dhe ushtrimin efektiv të të drejtave procedurale të palëve. ILD ka mbajtur në konsideratë natyrën dhe rrethanat e shkeljeve, shpeshtësinë e tyre, pasojat e provuara, vijimin e problematikave pavarësisht masave mbështetëse dhënë magjistrates nga drejtuesit e gjykatës, masës disiplinore të mëparshme "Vërejtje publike", si dhe rrethanat lehtësuese të mbështetura në prova, duke përjashtuar periudhat e justifikuara dhe shmangur vlerësimin e dyfishtë të të njëjtave fakte. Nga tërësia e shkeljeve të provuara ILD vlerëson se plotësohen kushtet që t'i propozohet KLGJ-së caktimi i masës disiplinore ***"Shkarkim nga detyra"*** për gjyqtaren A.Xh, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat "a", "ç", "d" dhe "f", si dhe neni 102, pika 2, shkronja "dh", të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.